



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
PRITOREN I ADMINISTRATIVES - DREKTORIA E ADMINISTRATIVES

Numri i Dëshmimit: 142

Data e Dëshmimit: 07.11.2016

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE

RREGULLORE

PËR

MENAXHIMIN E MBETURINAVE

Fushë-Kosovë, Tetor 2016

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2 shkronja (c), nenit 17, shkronja (f), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare 28/2008), nenit 15 paragrafi 7 dhe 8, të Ligjit për Mbeturina me Nr.04/L-060, nenit 12 paragrafit 12.1 shkronja (dh), nenit 13 paragrafi 13.6 shkronja (c) të Statutit të Komunës së Fushë-Kosovës Nr.98 të datës 17.08.2012 Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë: 31.10.2016 miraton:

RREGULLOREN PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME

Neni 1

Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim që të përmirësojë sistemin e grumbullimit të mbeturinave, menaxhimit të mbeturinave komunale, lartësinë e caktimit të taksës, me qëllim të krijimit të kushteve për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut nga ndotjet dhe rreziqet që vijnë nga mbeturinat.

Neni 2

Fushëveprimi

Kjo Rregullore definon minimizimin e mbeturinave, ndarjen, ruajtjen, shkarkimin, grumbullimin, transportin, aktivitetet e riciklimit, taksën për mbeturina me qëllim të ruajtjes së mjedisit jetësor në juridiksionin e Komunës.

Neni 3

Përkufizimet

1. **Mbeturina** - substancë apo objekt që prodhuesi apo zotëruesi e hedh, ka për qëllim ta hedh apo është i detyruar ta hedh.
2. **Menaxhim i mbeturinave** – aktivitetet për evitimin dhe reduktimin e prodhimit të mbeturinave dhe ndikimit të tyre në mjedis dhe shëndetin e njeriut, mbledhjen, transportin, trajtimin, ripërdorimin, përpunimin, riciklimin dhe deponimin përfundimtar të mbeturinës, përfshirë monitorimin dhe kujdesin edhe pas kryerjes së këtyre aktiviteteve.
3. **Operatori** - personi, i cili në përputhje me dispozitat e këtij ligji, menaxhon, kontrollon, është përgjegjës për objektet dhe pajisjet e mbeturinave dhe është i autorizuar të marrë vendime në lidhje me funksionet ekonomike ose teknike të pajisjeve dhe objekteve.
4. **Kompostimi** - trajtim i mbeturinave të biodegradueshme nën veprimin e mikroorganizmave në prezencën e oksigjenit, i cili kryhet me qëllim të prodhimit të kompostit nën kushtet e kontrolluara.
5. **Licenca** - për menaxhimin e mbeturinave - leje me shkrim e cila lëshohet me vendim të Ministrisë, me të cilën vërtetohet se janë plotësuar kushtet sipas këtij Ligji.
6. **Person** - person fizik ose juridik i cili është i involvuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose

tërthorazi, në proceset për menaxhimin e mbeturinave.

7. **Përpunim i mbeturinave** – operim, ku rezultati kryesor i të cilit është vënia në shërbim e mbeturinave për qëllime të dobishme, duke zëvendësuar materialet tjera të cilat përndryshe do të duhej përdorur për të plotësuar një funksion të caktuar, apo përgatitja e mbeturinës për të plotësuar ato funksione në ndonjë impiant apo ekonominë e gjerë.
8. **Trajtimi** - përpunimi apo deponimi përfundimtar, përfshirë përgatitjet para përpunimit ose deponimit përfundimtar.
9. **Riciklimi** - çdo operim të përpunimit nga i cili materialet mbeturinë janë rikthyer në produkte, materiale, substance, qoftë si origjinale, apo për qëllime tjera. Kjo përfshin rikthimin e materialeve organike por nuk përfshin përfitimin e energjisë dhe ripërpunimin në materiale që përdoren si karburante apo për operimet e mbulimit të mbeturinave.
10. **Prodhuës i mbeturinës** - çdo person, veprimtaria e të cilit krijon /prodhon mbeturinë ose çdonjëri që merret me paraprocesim, përzierje apo operime tjera që rezultojnë në ndryshimin e natyrës apo përbërjes së mbeturinës.
12. **Përdorimi i mbeturinave** - çdo operim, veprimtari që kryhet për qëllime riciklimi ose ripërdorimi të mbeturinave, pjesërisht ose në tërësi, duke përfshirë edhe çdo aktivitet të specifikuar.
13. **Mbeturina komerciale** - mbeturinat të cilat vijnë nga objektet që përdoren për qëllimet e tregut ose biznesit, sportit, edukimit, rekreacionit, por nuk përfshihen mbeturinat industriale.
15. **Deponi** - vendi i caktuar dhe i rregulluar për mbeturina, ku do të vendosen mbeturinat nën apo mbi sipërfaqe të tokës.
16. **Mbeturina komunale** - mbeturina nga amvisëritë dhe mbeturina nga aktivitetet tjera të cilat për shkak të përbërjes dhe natyrës së tyre, janë të ngjashme me ato të amvisërisë.
17. **Ripërdorimi** - çfarëdo operimi me të cilin çdo produkt apo komponent e cila nuk është mbeturinë dhe përdoret përsëri për të njëjtin qëllim për të cilin janë destinuar.
18. **Mbledhja** – mbledhje dhe transportim i mbeturinave duke përfshirë klasifikimin paraprak në lloje dhe magazinimin e mbeturinave për qëllime të bartjes deri në objektin për trajtim ose deponim të mbeturinave.
19. **Mbledhja e ndarë** - nënkupton mbledhjen kur grumbullimi i mbeturinave bëhet në mënyrë të ndarë në lloje, të klasifikuar sipas natyrës dhe pajisjeve për të lehtësuar trajtimin specifik.
21. **Mbeturina e demolim/konstruktimit** - mbeturinat që nuk paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut dhe që nuk posedojnë karakteristika të mbeturinave të rrezikshme.
22. **Mbeturinë e vëllimshme** - mbeturinat me përmasa të mëdha fizike nga pajisjet dhe makineritë, grumbullimi, transportimi dhe largimi i të cilave bëhet në mënyrë të veçantë.
24. **DSHPM** - Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit në kuadër të komunës, kompetente për menaxhim të mbeturinave.

II. DISPOZITAT E VEQANTA

Neni 4

Përgjegjësitë e Komunës

1. Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm për menaxhimin e mbeturinave komunale.
2. Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm financiar.
3. Kontraktimet për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave.
5. Monitoron dhe udhëzon ofruesit e shërbimeve për grumbullimin, transportimin dhe deponimin e mbeturinave.
6. Identifikimi i pikave ilegale të hudhjes së mbeturinave dhe nderrmerr masa për largimin e tyre.
7. Promovimi për minimizimin e mbeturinave në burim.
8. Promovimi i ngritjes së vetëdijesimit publik-pjesëmarrja aktive e qytetarëve në implementimin e menaxhimit të mbeturinave komunale.
9. Raportimi për menaxhimin e mbeturinave dhe shkallën e inkasimit për mbeturinat në institucionet relevante komunale.
10. Shqyrtimin e ankesave dhe parashtrësive të taksapaguesve për mbeturina.
11. Caktimi i takses për mbeturina.
12. Raportimi në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për Menaxhimin e mbeturinave deri më 31 mars të vitit vijues.
13. Të sigurojë kushte veprimi dhe operimi për operatorët publik dhe privat.

Neni 5

Të drejtat dhe detyrat e prodhuesit të mbeturinave

1. Çdo prodhues i mbeturinave ka të drejtë qasje në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave.
2. Çdo prodhues i mbeturinave ka të drejtë ankese ndaj shërbimit të ofruar.
3. Çdo prodhues i mbeturinave duhet të respektojë rregullat e shkarkimit të përcaktuar sipas planit të menxhimit të mbeturinave.
4. Çdo prodhues duhet të bëjë përpjekje për zvogëlimin e mbeturinave në burim (përmes kompostimit shtëpiak dhe formave tjera të mundshme, si ripërdorimi);
5. Për shërbimin e ofruar, prodhuesi obligohet të paguaj taksën e shërbimit;
6. Çdo prodhues duhet të bashkëpunojë me autoritetin publik, për të siguruar një mjedis të pastër;
7. Ndërmarrjet prodhuese, të cilat krijojnë mbeturina, obligohen që komunës së Fushë-Kosovës t'ia dorëzojnë planin e menaxhimit të mbeturinave, të cilat i krijojnë gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

Neni 6

Kontejnerët

1. Komuna përcakton: llojin, vëllimin, numrin, lokacionin dhe destinimin e kontejnerëve si dhe periudhën kohore të mbledhjes së mbeturinave.
2. Për mbledhje dhe ndarje të mbeturinave janë të aprovuara llojet vijuese të kontejnerëve dhe shportave sipas standardeve.
3. Madhësia e kontejnerit - pesha maksimale e lejuar është:
 - 3.1. 1.1m³, 440 kg mbeturina të amvisërisë;

- 3.2. 1.1m³ dhe 3.2m³ kontejnerë nëntokësor;
- 3.3. 7m³, 6000 kg mbeturina inerte (ndërtimore, etj);
- 3.4. 7m³, 6000 kg për mbeturinat nga pajisjet elektrike, elektronike dhe të vëllimshme;
- 3.5. 7m³, 6000 kg për mbeturinat të veçanta (hiri nga djegiet shtëpiake);
4. Madhësia e shportave për mbeturina të amvisërisë përcaktuar në litër:
 - 4.1. 60 litra;
 - 4.2. 80litra;
 - 4.3. 120 litra;
 - 4.4. 240 litra.
5. Kontejnerët duhet të jenë me ngjyra të ndryshme ose me mbishkrime të dukshme që udhëzojnë hedhjen e ndarë të mbeturinave.
6. Kontejnerët (metalik dhe të plastikës) duhet të kenë mekanizëm mbyllës, të jenë nga materialet adekuate dhe gjithmonë të mirëmbajtur.
7. Kontejnerët duhet të kenë sipërfaqe të lëmuara, lehtësisht të pastrueshme dhe materiali i tyre (metal, plastik etj.) duhet të jenë të qëndrueshëm dhe të papërshkueshëm nga uji.
8. Kontejnerët për mbeturina duhet të jenë teknikisht të përshtatshëm për automjetet që bëjnë zbrazjen e mbeturinave.
9. Shporta të vëllimeve të ndryshme, të vendosura në trotuare dhe parqe.

Neni 7

Funksionimi dhe Shërbimi me kontejnerë

1. Qytetarët duhet të jenë të informuar për llojin e kontejnerëve të ofruar nga Komuna në bashkëpunim me operatorin.
2. Qytetarët duhet që të shfrytëzojnë kontejnerët për hedhje dhe ndarje në mënyrë të përshtatshme.
3. Hedhja e mbeturinave shtëpiake nga banorët e objekteve të banimit kolektiv bëhet në vendin e kontejnerëve të përcaktuar nga Komuna.
4. Numri i kontejnerëve duhet të përshtatet me numrin e banorëve në objektet e banimit kolektiv dhe llojin e mbeturinave që krijojnë.
5. Në shtëpitë dhe objektet individuale private, personat duhet të kenë së paku dy shporta për hedhjen e mbeturinave të ndara.
6. Njëra shportë shërben për hedhjen e mbeturinave organike, ndërsa shportat tjera shërbejnë për mbeturina tjera të riciklueshme.
7. Spitalet, ambulancat dhe objektet tjera për shërbime mjekësore (publike dhe private), duhet të përdorin sistemin e ndarë të kontejnerëve me qëllim të ndarjes së mbeturinave medicinale dhe komunale (sistemi më së paku i tri shportave me të cilat përcaktohet qartë shenjëzimi).

Neni 8

Lokacioni i vendosjes se kontenjerëve

1. Kontejnerët për hedhje të mbeturinave duhet të vendosen në vende të dukshme të rregulluara sipas standardeve ndërtimore me mbulesë të siguruara dhe të përshtatshme ku nuk shkaktajnë pengesë apo rrezik për lëvizje të lirë të qytetarëve, automjeteve dhe qarkullim të mallrave.
2. Lokacionet e vendosjes së kontejnerëve i cakton Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, në përputhje me Planet Rregullative Urbanistike.
3. Kontejnerët dhe shportat e mbeturinave (publike), mund të ofrohen në përdorim nga ana e Komunës, operatorit dhe palëve të treta të kontraktuara.
4. Operatori, në bazë të marrëveshjes me autoritetet komunale, vendos numrin e nevojshëm të kontejnerëve në hapësirat e objekteve të banimit kolektiv.
5. Orarin dhe dinamikën e mbledhjes së mbeturinave e përcakton Komuna e Fushë-Kosovës në bashkëpunim me operatorin.
6. Sipas nevojës Komuna e Fushë-Kosovës autorizon operatorin që të bëjë mbledhjen e mbeturinave edhe jashtë orarit dhe dinamikës.

Neni 9

Dorëzimi i mbeturinave të konstruktiv/demolimit

1. Gjatë procesit të ndërtimit, meremetimit apo demolimit të objekteve, personat obligohen t'i largojnë nga hapësirat, ose vendet publike, mbeturinat të cilat i krijojnë dhe t'i dërgojnë në vendin e caktuar për deponim sipas destinimit të tyre.
2. Komuna e përcakton vendin për deponim të mbeturinave të konstruktiv /demolimit të objekteve ndërtimore.

Neni 10

Taksat për mbeturina

1. Taksa për mbeturinat nga janari i vitit 2017 do të faturohet dhe inkasohet nga Komuna ose Kompania me marrëveshje.
2. Faturimi i taksës së mbeturinave bëhet në baza mujore.
3. Taksa mujore për mbeturina kategorizohet si më poshtë:
3.1 Amvisëritë:
3.1.1 Zona Urbane – 4.70 €;
3.1.2 Zona Rurale – 4.70 €;

3.2. Bizneset:
3.2.1 Bizneset me sipërfaqe prej 1 deri 20 m² – 5.20€;
3.2.2. Bizneset me sipërfaqe prej 21 deri 50m² – 10.50€;
3.2.3. Bizneset me sipërfaqe prej 51m² deri 100m² – 18.50€;
3.2.4. Bizneset me sipërfaqe mbi 101m² – kontratë e veçantë-sipas sasisë së mbeturinave.

4. Shkalla e taksës do të rishikohet çdo shtator nga Komuna, duke marrë parasysh performancën e shkallës së inkasimit.
5. Kuvendi Komunal aprovon shkallën e përshtatshme të takeses të propozuar për vitin në vijim dhe në rast të ndryshimit njoftohen qytetarët para vitit të ardhshëm fiskal.

Neni 11

Detyrat dhe përgjegjësitë e operatorit të kontraktuar

1. Operatori i kontraktuar nga Komuna, për ofrimin e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave është i obliguar që të veprojë sipas kontratës dhe ligjeve në fuqi.
2. Operatorët e kontraktuar nga Komuna e Fushë-Kosovës obligohen që në mënyrë të rregullt të pastrojnë, mirëmbajnë teknikisht dhe dezinfektojnë kontejnerët e mbeturinave.

Neni 12

Ndërprerja e operimit për mbledhjen e mbeturinave

1. Ndërprerja e aktiviteteve të operatorit për mbledhjen e mbeturinave bëhet vetëm atëherë kur operatori nuk iu përmbahet kushteve të përcaktuara në kontratë.
2. Para se të ndërpritet kontrata, Komuna e Fushë-Kosovës njofton operatorin me shkrim lidhur me shkeljet e bëra, jep vërejtjet, propozon masat dhe cakton afatin kohor për zbatim të kushteve të kontratës.
3. Me rastin e ndërprerjes së kontratës, operatorit i ndalohet aktiviteti për mbledhjen e mbeturinave.

Neni 13

Detyrat e Inspektorit Komunal

Inspektori Komunal i Mjedisit dhe personat tjerë të autorizuar mbikëqyrin dhe inspektojnë menaxhimin e mbeturinave në objektet, pajisjet dhe hapësirat që gjenden në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, duke ndërmarrë masat për mbrojtjen e mjedisit, konform ligjeve në fuqi.

Neni 14

Ndalesat

1. Sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, ndalohet:
 - 1.1. Hedhja e mbeturinave ndërtimore në rrugë, në trotuare, sheshet e banuara apo në mjediset Publike.
 2. Hedhja e mbeturinave të llojeve tjera në kontejner ose në pikat mbledhëse për mbeturinat komunale të cilat nuk ndahen si mbeturina komunale.
 3. Hedhja e mbeturinave në hapësirat e përbashkëta brenda dhe jashtë objekteve të banimit kolektiv (ballkonet, korridoret, tarracat e banesave, etj.).

- 1.4. Hedhja e mbeturinave komunale në rrugë, trotuare, sheshet e banuara apo në mjedise tjera Publike.
- 1.5. Përzierja dhe hedhja e mbeturinave jashtë kontejnerëve të destinuar për ndarjen e mbeturinave të riciklueshme.
- 1.6. Hedhja e mbeturinave në rrugë nga automjetet në lëvizje.
- 1.7.. Ndërrimi i vendndodhjes së kontejnerëve, pikave ose vendeve të betonuara për hedhjen e mbeturinave pa autorizim të autoriteteve komunale.
- 1.8. Djegia e mbeturinave në vende publike, private, kontejner, ose në pikat mbledhëse, ndarëse të mbeturinave.
- 1.9.. Shfrytëzimi i mbeturinave si ushqim për kafshët apo të ngjashme nga kontejnerët ose nga pikat mbledhëse të mbeturinave.
- 1.10. Shfrytëzimi i kontejnerëve publik nga bizneset ekonomike për llojet e mbeturinave që nuk përfshihen në përkufizimin “mbeturinat komunale dhe komerciale”.
- 1.11. Gërmimi, përzierja, derdhja dhe përhapja e mbeturinave të hedhura në kontejner, ose në pikat mbledhëse nga personat e paautorizuar.
- 1.12. Hedhja e mbeturinave jashtë kontejnerit të mbeturinave.
- 1.13. Derdhja apo rrjedhja e mbeturinave prej automjeteve gjatë transportimit të të gjitha mbeturinave deri në deponi të mbeturinave.
- 1.14. Personat fizikë dhe juridikë duhet të sigurohen që, gjatë transportimit të mbeturinave, automjetet e tyre të kenë mbulesë adekuate me qëllim të pengimit të derdhjes, shpërndarjes apo rrjedhjes së mbeturinave gjatë transportit me destinacion tek deponitë përkatëse.
- 1.15. Mbeturinat nga pajisjet elektrike, elektronike, të rrezikshme dhe të vëllimshme nuk guxojnë të hudhen në kontejnerë të mbeturinave komunale ose në afërsi.

Neni 15

III. DISPOZITAT NDËSHKUESE

1. Personat fizik dhe juridik që nuk i përmbahen afateve të pagesës së faturave sipas kësaj Rregulloreje, ngarkohen me pagimin e borxhit me kamatë ligjore.
2. Personat që nuk i paguajn 3 fatura mujore të njëpasnjëshme, me vendim të veçant do të vendoset për mos ofrimin e shërbimeve komunale administrative me përjashtim të shërbimeve të ndërlidhura me rregullimin e dokumentacionit civil;
3. Nëse personi fizik dhe juridik nuk e bënë pagesën e gjashtë e më tepër faturave të mbeturinave do të inicohet procedurë gjyqësore në gjykatën kompetente.
4. Çdo personi fizik dhe juridik i cili nuk iu përmbahet dhe i shkel rregullat për mbrojtjen e mjedisit, do të ndëshkohet me gjobë mandatore nga 5€ deri në 100€ sipas Udhëzimit Administrativ Nr.14/2015 për Ndëshkimet me Gjoba Mandatore i hartuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor.

IV. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 16

Të gjitha rastet që nuk janë të rregulluara me këtë Rregullore do të zbatohen dispozitat e ligjeve në fuqi.

Neni 17

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje kompetent janë: Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, Drejtoria e Inspektoratit me njësitë ndërlidhëse për mbrojtjen e mjedisit dhe Policia e Kosovës.

Neni 18

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në Web faqen e komunës dhe fillon së zbatuari nga 01.01.2017.

Rr-Nr 142 2016

Datë 07.11.2016

Kuvendi i Komunës Fushë-Kosovë



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Dr.sc. Fadil Krasniqi